



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.54/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesat kundër subjektit politik Iniciativa Qytetare Për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.54/2025 dhe ZL.Anr.55/2025 të datës 23.09.2025 si dhe ZL.Anr.61/2025 të datës 25.09.2025
- II. Subjektit politik Iniciativa Qytetare Për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro .
- III. Detyrohet Subjekti politik Iniciativa Qytetare Për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.
- IV. Urdhërohet kandidati i subjektit politik Iniciativa Qytetare Për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), që nga momenti i marrjes së këtij vendimi t'i largoj nga rrjeti social Facebook postimet e datës 22.09.2025.

A r s y e t i m

Me datë 23.09.2025 PZAP-i ka pranuar dy ankesa ZL.A.nr.54/2025 dhe ZL.A.nr.55/2025 të datës 23.09.2025 si dhe më datë 25.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë ZL.A.nr.61/2025 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ku në ankesën ZL.A.nr.54/2025 të datës 23.09.2025 pretendon se më datë 22.09.2025, kandidati për Kryetar të Skenderajt, Sokol Halili, nga subjekti politik "Iniciativa Qytetare për Skenderaj", në rrjetin social Facebook, ka postuar një video që përmban gjuhë kërcënuese, fyese dhe nxitje të urrejtjes ndaj kandidatit të PDK-së, për kryetar të kësaj Komune, Sami Lushtaku, ku në video-incizimin e publikuar në rrjetin social Facebook ,z.Sokol Halili krahason largimin e pushtetit lokal në Skenderaj me largimin e "pushtetit gjencidal serb" dhe ndër të tjera ka përdorur shprehjet: "kriminel",

"hajn", "banda kriminale" "spion", duke shtuar se këto shprehje jo vetëm që përbejnë fyerje personale, por përbejnë edhe elemente të qartë të gjuhës së urrejtjes, të cilat mund të konsiderohen si nxitje ndaj dhunës dhe përçarje mes qytetarëve, duke theksuar se këto deklarime janë veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se vijnë nga kandidat për një funksion publik i cili duhet të shërbej si shembull i përgjegjshmërisë dhe respekti ndaj kundërshtarëve politikë.

Në ankesën ZL.A.nr.55/2025 të datës 23.09.2025, parashtruesi i ankesës pretendon se më datë 22.09.2025, kandidati për Kryetar të Skenderajt, Sokol Halili, nga subjekti politik "Iniciativa Qytetare për Skenderajt", në rrjetin social Facebook, ka bërë një postim që përmban gjuhë kërcënuese, fyese dhe nxitje të urrejtjes ndaj kandidatit të PDK-së, për kryetar të kësaj Komune, Sami Lushtaku, ku në postimin e publikuar në rrjetin social Facebook, z.Sokol Halili krahason largimin e pushtetit lokal në Skenderaj me largimin e "pushtetit gjenocidal serb" dhe ndër të tjera ka përdorur shprehjet: "kriminel", "bandit", "banda" dhe "arkitekt i të gjitha krimeve", duke shtuar se këto shprehje jo vetëm që përbejnë fyerje personale, por përbejnë edhe elemente të qartë të gjuhës së urrejtjes, të cilat mund të konsiderohen si nxitje ndaj dhunës dhe përçarje mes qytetarëve, duke theksuar se këto deklarime janë veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se vijnë nga kandidat për një funksion publik i cili duhet të shërbej si shembull i përgjegjshmërisë dhe respekti ndaj kundërshtarëve politikë.

Në ankesën ZL.A.nr.61/2025 të datës 25.09.2025, parashtruesi i ankesës pretendon se më datë 23.09.2025, kandidati për Kryetar të Skenderajt, Sokol Halili, nga subjekti politik "Iniciativa Qytetare për Skenderajt", në një debat televiziv, ka përdorur gjuhë kërcënuese, fyese dhe nxitje të urrejtjes ndaj kandidatit të PDK-së për kryetar të kësaj komune, z.Sami Lushtaku. Në këtë debat televiziv, Sokol Halili, ndër të tjera, shprehet se: "Sami Lushtaku është i njohur për famën e tij, karakteristikën e tij tipike kriminele ashtu siç është i njohur Millan Radojqiç në veri", duke shtuar se këto shprehje jo vetëm që përbejnë fyerje personale, por përbejnë edhe elemente të qartë të gjuhës së urrejtjes, të cilat mund të konsiderohen si nxitje ndaj dhunës dhe përçarje mes qytetarëve, duke theksuar se këto deklarime janë veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se vijnë nga kandidat për një funksion publik i cili duhet të shërbej si shembull i përgjegjshmërisë dhe respekti ndaj kundërshtarëve politikë.

Me këtë sipas parashtruesit të ankesave është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 i cili shprehimisht thotë: "përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë."

Si provë parashtruesi i ankesave ZL.Anr.54/2025 dhe ZL.Anr.55/2025 të datës 23.09.2025 ka bashkëngjitur videon dhe foton e postimit nga llogaria sociale Facebook e kandidatit për kryetar të Komunës së Skenderajt Sokol Halili: <https://www.facebook.com/share/v/1FVDCKHEUw/>.

Gjithashtu , si provë për ankesën ZL.A.nr.61/2025 të datës 25.09.2025 ,parashtruesi i ankesës ka bashkëngjitur linqet e deklarimit të bëra nga kandidati për kryetar të Komunës së Skenderajt Sokol Halili : <https://www.facebook.com/share/v/16P5zF6rb7/>Halili e krahason Lushtakun me Radoiqiqin-KOHA.net

Kandidati i Iniciativës Qytetare për kryetar të komunës Skenderaj, Sokol Halili nuk është përgjigjur dhe nuk ka ofruar ndonjë përgjigje lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesave.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr..05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.A.nr.54/2025 dhe ZL.A.nr.55/2025 të datës 23.09.2025, si dhe ZL.A.nr.61/2025 të datës 25.09.2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZL.A.nr.54/2024, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si prova materiale në ankesat, të cilat janë bërë nga Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, nga e cila rrjedh se kandidati për kryetar të Skenderajt nga subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj Sokol Halili, përmes llogarisë së tij në rrjetin social Facebook ku në një video-incizim dhe në një postim të tij krahason largimin e pushtetit lokal në Skenderaj me largimin e "*pushtetit gjenocidal serb*" dhe ndër të tjera ka përdorur shprehjet: "*kriminel*", "*hajn*" , "*banda kriminale*" "*spiun*", "*bandit*", dhe "*arkitekt i të gjitha krimeve*" si dhe në një debat televiziv, Sokol Halili, ka përdorur gjuhë kërcënuese, fyese dhe nxitje të urrejtjes ndaj kandidatit të PDK-së për kryetar të kësaj komune, z.Sami Lushtaku, ku Sokol Halili , shprehet se : "*Sami Lushtaku është i njohur për famën e tij, karakteristikën e tij tipike kriminele ashtu siç është i njohur Millan Radojqi në veri*", ka vërtetuar se ankesat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*", andaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga kandidati i Iniciativës Qytetarë për Skenderaj Sokol Halili, ndaj kandidatit për kryetar të Komunës e Skenderajt të PDK-së Sami Lushtaku në fushatë zgjedhore dhe përdorimi i termave në video-incizimin dhe postimin e tij ku Sokol Halili krahason largimin e pushtetit lokal në Skenderaj me largimin e "pushtetit gjenocidal serb" dhe ndër të tjera ka përdorur shprehjet: "kriminel", "hajn", "banda kriminale", "spiun", "bandit" dhe "arkitekt i të gjitha krimeve" kundrejt kandidatëve tjerë, si dhe krahasimet e kandidatëve me "pushtetit gjenocidal serb" apo "Sami Lushtaku është i njohur për famën e tij, karakteristikën e tij tipike kriminele ashtu siç është i njohur Millan Radojqiç në veri", është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 33 par. 5 dhe nenit 34 paragrafi 1, pika l.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike.

Në këtë rast është marrë për bazë konteksti, qëllimi dhe shprehjet e përdorura në rrjetin social Facebook dhe në debatin televiziv nga Sokol Halili, prandaj, sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim nxitje të dhunës dhe urrejtjes. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga Iniciativa Qytetarë për Skenderaj, kandidati Sokol Halili, sipas Panelit është shkelje e etikës zgjedhore dhe standardeve të sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP-i me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklaratat janë bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se nxit dhunë dhe urrejtje politike.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidati, përkatësisht subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj duhet që ta largoj postimin nga rrjeti social Facebook, të datës 22.09.2025, ndërsa dështimi për ta bërë këtë-për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP, ashtu siç është përcaktuar me nenin 120, par.2 të LZP.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, përkatësisht faktin se i njëjti subjekt në këtë fushatë zgjedhore është dënuar edhe më parë për përdorim të gjuhës së urrejtjes ndaj subjektit të njëjtë me vendimet nën shenjën ZL.A.nr.45/2025, të datës 20.09.2025, me të cilin i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1500 euro dhe ZL.A.nr.51/2025 të datës 23.09.2025 ku i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 5,500.00 euro, (pesëmijepesëqind euro).

Paneli për të caktuar lartësinë e gjobës se shqiptuar ka marrë për bazë faktin se Iniciativa Qytetarë për Skenderaj, nuk është përfitues i Fondit për Financimin e Subjekteve Politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 33 par. 5 dhe nenit 34 pika l.11, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr. 54/2025 datë 26.09.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborat Paneli za Zahtiri i Predstavke

10 -10- 2025

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 5415 Ora/Sat 08:45



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.88/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Milena Deric, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik, Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr. 54/2025, të datës 26.09.2025, në seancën e mbajtur më datë 09.10.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik, Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.54/2025, të datës 26.09.2025.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.54/2025, të datës 26.09.2025, ka vendosur: I. Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.54/2025 dhe ZL.Anr.55/2025, të datës 23.09.2025, si dhe ZL.Anr.61/2025, të datës 25.09.2025. II. Subjektit politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro. III. Detyrohet Subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi. IV. Urdhërohet kandidati për kryetar i subjektit politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj Sokol Halili që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj nga rrjeti social facebook postimet e datës 22.09.2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata



Supreme të aprovojë ankesën e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili) si të bazuar, ndërsa të anulohet vendimi ZL.Anr.54/2025, i datës 26.09.2025.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL. Anr.54/2025, i datës 26.09.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 23.09.2025 PZAP-i ka pranuar dy ankesa ZL.A.nr.54/2025 dhe ZL.A.nr.55/2025, të datës 23.09.2025, si dhe më datë 25.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë ZL.A.nr.61/2025 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ku në ankesën ZL.A.nr.54/2025, të datës 23.09.2025, pretendon se më datë 22.09.2025, kandidati për Kryetar të Skenderajt, Sokol Halili, nga subjekti politik "Iniciativa Qytetare për Skenderaj", në rrjetin social Facebook, ka postuar një video që përmban gjuhë kërcënuese, fyese dhe nxitje të urrejtjes ndaj kandidatit të PDK-së, për kryetar të kësaj Komune, Sami Lushtaku, ku në video-incizimin e publikuar në rrjetin social Facebook, z. Sokol Halili krahason largimin e pushtetit lokal në Skenderaj me largimin e "pushtetit gjenocidal serb" dhe ndër të tjera ka përdorur shprehjet: "kriminel", "hajn", "banda kriminale" "spiun", duke shtuar se këto shprehje jo vetëm që përbejnë fyerje personale, por përbejnë edhe elemente të qartë të gjuhës së urrejtjes, të cilat mund të konsiderohen si nxitje ndaj dhunës dhe përçarje mes qytetarëve, duke theksuar se këto deklaramë janë veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se vijnë nga kandidat për një funksion publik i cili duhet të shërbej si shembull i përgjegjshmërisë dhe respekti ndaj kundërshtarëve politikë.

Subjektit politik, Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë, lidhur me pretendimet e parashtresit të ankesave.

PZAP-i, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore ka nxjerr vendimin ZL.Anr. 54/2025, të datës 26.09.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si prova materiale në ankesat, të cilat janë bërë nga Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, nga e cila rrjedh se kandidati për kryetar të Skenderajt nga subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj Sokol Halili, përmes llogarisë së tij në rrjetin social Facebook ku në një video-incizim dhe në një postim të tij krahason largimin e pushtetit lokal në Skenderaj me largimin e "pushtetit gjenocidal serb" dhe ndër të tjera ka përdorur shprehjet: "kriminel", "hajn", "banda kriminale" "spiun", "bandit", dhe "arkitekt i të gjitha krimeve" si dhe në një debat televiziv, Sokol Halili, ka përdorur gjuhë kërcënuese, fyese dhe nxitje të urrejtjes ndaj kandidatit të PDK-së për kryetar të kësaj komune, z. Sami Lushtaku, ku Sokol Halili, shprehet se: "Sami Lushtaku është i njohur për famën e tij, karakteristikën e tij tipike kriminele ashtu siç është i njohur Millan Radojqiç në veri", ka vërtetuar se ankesat janë



të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë", andaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura. Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga kandidati i Iniciativës Qytetarë për Skenderaj Sokol Halili, ndaj kandidatit për kryetar të Komunës e Skenderajt të PDK-së Sami Lushtaku në fushatë zgjedhore dhe përdorimi i termave në video-incizimin dhe postimin e tij ku Sokol Halili krahason largimin e pushtetit lokal në Skenderaj me largimin e "pushtetit gjenocidal serb" dhe ndër të tjera ka përdorur shprehjet: "kriminel", "hajn" "banda kriminale" "spiun" "bandit" dhe "arkitekt i të gjitha krimeve" kundrejt kandidatëve tjerë, si dhe krahasimet e kandidatëve me "pushtetit gjenocidal serb" apo "Sami Lushtaku është i njohur për famën e tij, karakteristikën e tij tipike kriminele ashtu siç është i njohur Millan Radojqi në veri", është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 33 par. 5 dhe nenit 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti, qëllimi dhe shprehjet e përdorura në rrjetin social Facebook dhe në debatin televiziv nga Sokol Halili, prandaj, sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim nxitje të dhunës dhe urrejtjes. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga Iniciativa Qytetarë për Skenderaj, kandidati Sokol Halili, sipas Panelit është shkelje e etikës zgjedhore dhe standardeve të sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP-i me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklaratat janë bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se nxit dhunë dhe urrejtje politike.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidati, përkatësisht subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj duhet që ta largoj postimin nga rrjeti social Facebook, të datës 22.09.2025, ndërsa dështimi për ta bërë këtë-për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP, ashtu siç është përcaktuar me nenin 120, par.2 të LZP. Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, përkatësisht faktin se i njëjti subjekt në këtë fushatë zgjedhore është dënuar edhe më parë për përdorim të gjuhës së urrejtjes ndaj subjektit të njëjtë me vendimet nën shenjë ZL.A.nr.45/2025, të datës 20.09.2025, me të cilin i është shqiptuar dënim



me gjobë në shumë prej 1500 euro dhe ZL.A.nr.51/2025 të datës 23.09.2025 ku i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 5,500.00 euro, (pesëmijepesëqind euro). Paneli për të caktuar lartësinë e gjobës se shqiptuar ka marrë për bazë faktin se Iniciativa Qytetare për Skenderaj, nuk është përfitues i Fondit për Financimin e Subjekteve Politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave. Kjo për faktin se në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja nga subjektit politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj (Kandidati Sokol Halili), e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet, e paraparë në nenin 34, 1.11, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 24 paragrafi 9 pika 1 dhe 2 të Rregullores nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave. Meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur nuk i është referuar shkeljeve konkrete të dispozitave të procedurës ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, por vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në trajtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, përkritazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike ashtu siç thekson parashtruesi i ankesës dhe se këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP vendimin e atakuar e bazon në prova konkrete, të qarta dhe ekzistuese të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe ka vërtetuar pretendimet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Gjithashtu të njëjtat janë në lidhshmëri me rastin që është objekt i shqyrtimit, konkretisht me deklaratimet ku theksohet se: kandidati për kryetar të Skenderajt nga subjekti politik Iniciativa Qytetare për Skenderaj Sokol Halili, përmes llogarisë së tij në rrjetin social Facebook ka përdorur shprehjet si: “kriminel”, “terrorist”, “tiran”, “shok i Milan Radojçiqit”, duke iu drejtuar kështu kandidatit të PDK-së për kryetar të Komunës së Skenderaj, Sami Lushtakut, me çka është shkelur Kodi e Mirësjelljes dhe në veçanti nenin 34. 1.11. ku parashihet se: “ 1 Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11 përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.



Si rezultat i kësaj, Gjykatës Supreme e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të PZAP-it se gjuha e tillë e përdorur në kuadër të fushatës zgjedhore e cila është përshkruar si më lartë, ka për qëllim nxitjen dhunës dhe urrejtjes, për çka edhe paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes, ndërsa për këtë arsye e aprovon qëndrimin e këtij të fundit lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrethanash të precizuara më afër në arsyetimin e vendimit të tij, përfshirë këtu shkallën dhe peshën e shkeljes, si dhe natyrën e shkeljes, ndërsa lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €, për çka Gjykata Supreme vlerëson se dënimi i shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 10,000.00 €, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo edhe për faktin se nga PZAP-i me të drejtë është marr parasysh edhe rrethana se përsëritjes së shkeljeve të sanksionuara me Kodin e Mirësjelljes, pasi që ky subjekt politik rezulton të jetë gjobitur edhe më herët për gjuhë të pa përshtatshme në fushatë zgjedhore, saktësisht me vendimet ZL.Anr.45/2025 dhe ZL.Anr.51/2025. Si rrjedhojë e kësaj, nuk qëndron as pretendimi i ankuesit se i njëjti merr pjesë në zgjedhje për herë të parë dhe nuk e ka ditur se kjo gjuhë konsiderohet si shkelje e ligjit për zgjedhjet. Në anën tjetër, me lartësinë e gjobës së shqiptuar vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, e që është jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve të tjera, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodin e Mirësjelljes.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e ankuesit për formën dhe përmbajtjen e vendimit janë të pabazuara, për faktin se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kolegji i kësaj gjykate konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtresit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 120.1.3 dhe 34.1 (11), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.m.88/2025, datë 09.10.2025



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
STACNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS / СУДСКИ САВЕТ КОСОВА / KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA-88/2025
Oznaka spisa:

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PARISHITIM

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit mëdhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërrësës, fqiu, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ina izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (približno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201__ në ora _____ cas.
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

(Të panevojshmeve bjeri vize - nepotrebnje precrati)

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT 67 UKIN 09.10.2025

Numri i shtojcave: 2
broj priloga

Vërtetohet se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavenog pisma
(i slovima)

08.10.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Popis pritioaca ili lica koje je
pismo primilo u zameni)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Ne rasi se marrësi është analibet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesit, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vendë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se popise, potpisuje ga dostavljač. Napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.